



PRANUAR ME: 31.08.2023
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO:
Nr. Pr. 02 / 419



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/_____

Datë: 29.08.2023

Në bazë të nenit 8, nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17, nenit 24, nenit 40 paragrafi 2 shkronja (c), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 2, paragrafi 2.1,2.3 , të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal , nenit 8, paragrafi 9 të Rregullores Nr.02/236 datë: 13.05.2022 për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, në bazë të nenit 10, nenit 19 paragrafi 7 shkronja (b), nenit 40, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e mbledhjes së gjashtë (VI) të rregullt të mbajtur me datë: 14.08.2023 merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet kërkesa Nr.02/199 datë:06.04.2023 e parashtruar nga Luljeta Telaku nga fshati Banjë Komuna e Malishevës për mbështetje financiare, për botimin e librit “Plagë e pashërueshme” (Rrëfime të grave dhe nënave të dëshmorëve për vuajtjet dhe përjetimet e luftës).

2.Bazuar në pikën e 1 të këtij vendimi Luljeta Telaku nga fshati Banjë i ndahen mjetet financiare në shumë prej 1.500.00 (njëmijëpesqind euro), në emër të ndihmës momentale, për botim të librit.

2.1Mjetet në shumë prej 1.500.00euro (njëmijëpesqind euro) ndahen nga kategoria e subvencioneve-blloku kodues 10/625/16013/200/0000/0111, zyra e kryetarit.

3. Këtij vendimi i bashkangjiten: kërkesa, letërnjoftimi dhe konfirmi i bankës.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.

6.Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi sipas nenit 81 të Ligjit nr03/040, për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.06.2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

MAPL-së

Arkivit të Komunës

Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.

